

VENDIME JASHTË MBLEDHJEVE TË BORDIT

Vendimi 2019-01K

Data: 20.03.2019

Rritja e mëditjeve për trajner për “Tennis Fest 2019”

Pas kërkesës së trajnerëve të Prishtinës për rritjen e mëditjeve të tyre për angazhimin në “Tennis Fest 2019”, Kryetari Rexhepi mori vendim për të ndryshuar pagesën për këtë eveniment nga €30 në €50 për ditë.

Ky vendim vlen vetëm për aktivitetin “ Dita e Tenisit në Prishtinë 2019”, në të cilin do të angazhohen trajnerët:

- | | |
|--------------------|-------------------|
| 1. Granit Bajraliu | 4. Bajram Ibrahim |
| 2. Arian Ibrahim | 5. Edon Ademi |
| 3. Festim Ibrahim | 6. Dionis Sadiku |

Vendimi Nr. 2019-18

Data: 25.03.2019

Albanian Bowl 2019

Nga 27-30 mars tenistët e grupmoshave të reja do të marrin pjesë në turneun “Albania Bowl 2019” organizuar nga Federata Shqiptare e Tenisit.

Për këtë turne Bordi ka aprovuar propozimin që si shoqërues të angazhohen trajnerët Sami Ukëhaxhaj dhe Durim Morina.

Nuk ka kufizim në numrin e pjesëmarrësve.

Vendimi Nr. 2019-19

Kampi për grupmoshat U12- Ulqin

Data: 03.04.2019

Bordi merr vendim që nga 15-21 prill në Ulqin, FTK në bashkëpunim me Klubin e Tenisit “Bellevue” do të organizojnë Kampin për grupmoshat U12 dhe U14, ku selektor për grupmoshat U12 do të jetë trajneri Lorik Haxhishabani ndërsa për grupmoshat U14 trajneri Granit Bajraliu.

Në kamp do të angazhohen edhe 3 ndihmës trajnerë: Edon Ademi, Festim Ibrahim, Lirigzon Latifi.

Shpenzimet e akomodimit dhe ushqimit do të mbulohen nga klubi “Bellevue”, ndërsa Federata do të mbulojë shpenzimet e transportit dhe mëditjeve.

Vendimi Nr. 2019-20

Data: 06.04.2019

Formimi i Komisionit për Referë

Me hyrjen në fuqi të rregullores për këshillin e referëve të tenisit të Kosovës të datës 13 dhjetor 2018, dhe në përputhje me nenin 5 pika 5.2. Bordi miraton propozimin e KRTK-së për formimin e Komisionit të KRTK-së në përbërje:

1. Kryesues- Argjend Lecaj;
2. Anëtar- Fatmir Kabashi;
3. Anëtar- Tarkan Kosova.

Mandati i rregullt i Kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit është dy (2) vjeçar.

Vendimi Nr. 2019-02K

Data: 10.04.2019

Shkuarja në Lojërat Olimpike Rinore – Baku 2019

Në pamundësi që selektori G. Bajraliu të shkojë në Lojërat Olimpike Rinore (shkak angazhimet e tij në Davis Cup), Kryetari Rexhepi vendos që si trajner të dërgohet Festim Ibrahimimi.

Për lojërat Olimpike Rinore “Baku 2019” selektori G. Bajraliu ka përzgjedhur tenistët:

- | | |
|-----------------|-------------------|
| 1. Vesa Gjinaj | 3. Melos Nallbani |
| 2. Forta Morina | 4. Fresk Sylhasi |

Vendimi Nr. 2019-03K

Data: 21.05.2019

Rikonstruktimi i pozitës së z. Jeton Hadërgjonaj

Kryetari Rexhepi rikonstruktoi pozitën e z. Jeton Hadërgjonaj pas dorëheqjes së tij nga posti i nënkryetarit të FTK-së. Heqja dorë nga posti i nënkryetarit mundësoi që z. Hadërgjonaj të merr përsipër përsëri pozitën e trajnerit nacional “National Coach” dhe selektorit “Davis Cup”.

Vendimi Nr. 2019-21

Data: 22.05.2019

Formimi i Komisionit për Referë

Pas dorëheqjes së Kryesuesit të KRTK-së, z. Lecaj, Bordi miraton përbërjen e re të Komisionit Udhëheqës të KRTK-së, i propozuar nga Këshilli, si në vijim:

1. Kryesues- Tarkan Kosova;
2. Anëtar- Fatmir Kabashi;
3. Anëtar- Arzen Rifati.

Vendimi Nr. 2019-22

Data: 25.05.2019

Pjesëmarrja e femrave në Kampionat Ekipor

Në sajë të mungesës për t'u organizuar Kampionat Ekipor i veçantë për femra, me shumicë votash Bordi miraton propozimin për të lejuar pjesëmarrjen e femrave në Kampionat Ekipor.

Sipas këtij vendimi femrat kanë të drejtë pjesëmarrje në garat e Kampionatit Ekipor deri në momentin kur fillon organizimi i veçantë i kampionatit për femra.

Vendimi Nr. 2019-04K

Data:06.06.2019

Tërheqja nga “ European Summer Cups 2019” dhe “Junior Championships 2019 - U16”

Kryetari Rexhepi merr vendim për tërheqjen e grupmoshave U14 dhe U16 nga “European Summer Cups” për vitin 2019. Njëkohësisht merret vendim edhe për tërheqjen nga “TE Junior Championships 2019 - U16” që mbahen në Sochi, Rusi.

Kategoritë U14 do të marrin pjesë në “European Junior Championships 2019” ndërsa kategoria U16 në “Baku 2019”, andaj në këtë periudhë lojtarët kualitativ për garë janë të angazhuar mjaftueshëm dhe paraqitja edhe në turnetë e tërhequr shihet si e pa mundshme.

Selektori A. Ibrahimimi do të shoqërojë ekipin për “Junior Championships U14”, për të cilin ka përzgjedhur tenistët:

- 1) Melos Nallbani;
- 2) Aja Broqi;
- 3) Rita Miftari; dhe
- 4) Jon Jakupi

Vendimi Nr. 2019-05K

Data:13.06.2019

Përgatitjet e ekipit U16 për Baku 2019

Me vendim të Kryetarit miratohet vendi për mbajtjen e përgatitjeve të ekipit për Lojërat Olimpike Rinore “Baku 2019”. Përgatitjet do të mbahen në Klubin e Tenisit Tennis-park-Shkup, nga data 24 qershor deri 09 korrik, shpenzimet e të cilave (rreth €5,000) do të rimburohen nga Komiteti Olimpik i Kosovës.

Javën e parë ekipi do të shoqërohet nga trajneri Festim Ibrahimimi, ndërkaq javën e dytë nga Mentor Morina.



Vendimi Nr. 2019-06K

Data: 20.06.2019

Ekipi i projektit për turneun TE “Peja Open U16-2019”

Kryetari Rexhepi mori vendim që grupi punues i cili do të angazhohet në organizmin e turneut Tennis Europe “Peja Open 2019” për grupmoshat U16 do të përbëhet nga z. Mejdri Rexhepi, z. Shkëlzen Domi dhe z. Kreshnik Arifi. Sipas nevojës në projekt do të angazhohen edhe individ të tjerë.

Turneu do të mbahet në Brestovik, Pejë nga data 02-08 Shtator 2019.

Vendimi Nr. 2019-23

Data: 26.06.2019

Plani për Davis Cup 2019

Me shumicë votash aprovohet plani i propozuar nga trajneri Nacional për përgatitjet e ekipit “Davis Cup 2019” për Kampionat që do të mbahet nga 15-21 korrik në San Marino.

Përgatitjet do të mbahen nga 22 Qershor deri 11 Korrik 2019, intensiv 3 herë në javë nga 2 orë ushtrime, në fushat e tenisit të K.T. Rilindja.